



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 379 prot.

Tiranë, më 26.03.2019

VENDIM

Nr.20, datë 26.03.2019

PËR

PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 38, DATË 27.04.2018, NË
INSTITUCIONIN E AUTORITETIT
TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 38, datë 27.04.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

KONSTATOVA SE:

Bazuar në Urdhrin nr. 77 (773/1 prot.), datë 05/10/2018 “Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 38, datë 27.04.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, nëpërmjet Vendimit nr. 202, datë 04.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përsa i takon procesit të rekrutimit në shërbimin civil, duke vlerësuar edhe veprimet e tjera administrative të kryera lidhur me këtë institut të ligjit.

Institucioni i AAC, pasi është njohur me materialin, ka depozituar pranë Komisionerit, observacionet përkatëse, si dhe raportin e nënshkruar nga titullari i institucionit, me shkresën nr. 600/1 prot., datë 16.03.2018.

Komisioneri, pas përfundimit të mbikëqyrjes, me shkresën nr. 299/5 prot, datë 27.04.2018, ka dërguar pranë institucionit të AAC raportin përfundimtar lidhur me administrimin e shërbimit civil.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport dhe detyrat e lëna për Autoritetin e Aviacionit Civil, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, pas verifikimit në subjekt të veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezultojnë si më poshtë:

- ✓ *Konstatimi si absolutisht i pavlefshëm, i aktit nr. 302, datë 30.04.2014, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Jurist”, në Aeroportin e Kukësit dhe rikthimin e tij në një pozicion të barazvlefshëm me pozicionin ku e gjeti dhe fillimi i efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil.*

Me aktin nr. 569, datë 20.11.2017, të Drejtorit Ekzekutiv është konstatuar pavlefshmëria e aktit nr. 302, datë 30.04.2014 dhe më pas, me aktin nr. 2397/24, datë 10.04.2018, të Departamentit të Administratës Publike, nëpunësi është emëruar “*Specialist në Sektorin e Kontratave dhe Shërbimeve*”.

- ✓ *Plotësimi i kriterit arsimor (pajisja me diplomë master), për punonjësit ***** dhe *****.*

Konstatohet se nëpunësit e mësipërm kanë paraqitur pranë burimeve njerëzore diplomat përkatëse të arsimit. Pas plotësimit të këtij kriteri, Departamenti i Administratës Publike ka nxjerrë aktet e deklaramit si më poshtë:

- Akti nr. 2397/22, datë 10.04.2018, për punonjësin *****, “Inspektor” në Sektorin e Operimeve dhe Mbikëqyrjes.
- Akti nr. 2347/23, datë 10.04.2018, për punonjësin *****, “Përgjegjës” në Sektorin e Mbikëqyrjes Operacionale.
- ✓ *Lidhur me përfundimin e procedurës së kërkuar në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për përcaktimin e statusit të punësimit për punonjësen *****.*

Konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, pas verifikimit të kriterëve të përcaktuara në dispozitën e sipërpërmendur, ka nxjerrë aktin nr. 2347/25, datë 10.04.2018, për punonjësen *****, si nëpunës civil në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Parrezikshmërisë”.

- ✓ *Situata në lidhje me emërimet me kontratë të përkohshme në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil:*

Në lidhje me orientimin e Komisionerit në pikën 5 të vendimit të paralajmërimit, objekt verifikimi, për 31 punonjësit e emëruar me kontratë të përkohshme, në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nga këqyrja e dokumentacionit të administruar nga grupi i punës gjatë verifikimit në subjekt, vërej se, në 30 raste është konstatuar pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i institucionit në kundërshtim me legjislacionin për shërbimin civil, me aktet si më poshtë:

1. *****, akti nr. 537, datë 08.11.2017;
2. *****, akti nr. 89, datë 27.02.2018;
3. *****, akti nr. 90, datë 27.02.2018;
4. *****, akti nr. 92, datë 27.02.2018;
5. *****, akti nr. 80, datë 19.02.2018;
6. *****, akti nr. 88, datë 27.02.2018;
7. *****, akti nr. 161, datë 27.04.2018;
8. *****, akti nr. 87, datë 27.02.2018;
9. *****, akti nr. 86, datë 27.02.2018;
10. *****, akti nr. 91, datë 27.02.2018;
11. *****, akti nr. 168, datë 07.05.2018;
12. *****, akti nr. 5377 prot., datë 16.02.2018;
13. *****, akti nr. 93, datë 27.02.2018;

14. *****, akti nr. 504, datë 09.10.2017;
15. *****, akti nr. 1555 prot., datë 17.11.2017;
16. *****, akti nr. 6919 prot., datë 27.09.2018;
17. *****, akti nr. 557, datë 20.11.2017;
18. *****, akti nr. 514, datë 17.10.2017;
19. *****, akti nr. 513, datë 17.10.2017;
20. *****, akti nr. 563, datë 20.11.2017;
21. *****, akti nr. 565, datë 20.11.2017;
22. *****, akti nr. 594, datë 18.12.2017;
23. *****, akti nr. 595, datë 18.12.2017;
24. *****, akti nr. 511, datë 17.10.2017;
25. *****, akti nr. 517, datë 23.12.2017;
26. *****, akti nr. 559, datë 20.11.2017;
27. *****, akti nr. 564, datë 20.11.2017;
28. *****, akti nr. 512, datë 17.10.2017;
29. *****, akti nr. 568, datë 20.11.2017;
30. *****, akti nr. 567, datë 20.11.2017

Për një punonjëse është ndërprerë marrëdhënia e punës nëpërmjet dorëheqjes. Bëhet fjalë për punonjësen *****, e cila është liruar nga detyra me aktin nr. 596, datë 18.12.2017, *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”*.

Pozicionet e mbetura të lira, janë shpallur si të tilla dhe kanë filluar procedurat e emërimit të punonjësve sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Aktualisht, pjesa më e madhe e pozicioneve të lira është plotësuar, por ende ka disa pozicione për të cilat kjo procedurë është në vazhdim.

- ✓ *Lidhur me konstatimin e pavlefshmërisë së akteve të emërimit, për punonjësit ***** dhe ***** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese “Drejtor”, si dhe ***** në pozicionin “Përgjegjës”, si akte të dala në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe trajtimin e tyre në bazë të kategorisë së pozicionit të punës që zotëronin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit:*

Konstatohet se, për punonjësit e mësipërm, është vepruar sipas orientimeve të Komisionerit, duke konstatuar pavlefshmërinë e akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil dhe kalimin e tyre në pozicionet e punës, që punonjësit zotëronin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit në fjalë, si më poshtë:

- për *****, në përfundim të periudhës së provës, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr. 4353/2 prot, datë 21.06.2018 “*Akti i deklaramit të statusit të punësimit*”, si nëpunës civil, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerëve;
 - për punonjësen *****, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr. 2347/25, datë 10.04.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Sektorin e Parrezikshmërisë.
 - për *****, në përfundim të periudhës së provës, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr. 2804/5 prot., datë 14.05.2018 “*Akti i deklaramit të statusit të punësimit*”, si nëpunës civil, në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Transportin Ajror;
- ✓ *Në lidhje me kërkesat e pikës 7 të Vendimit paralajmërues, mbi finalizimin e procesit të periudhës së provës:*

Njësia përgjegjëse (DAP) ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të nëpunësit në përfundim të periudhës së provës, për secilin punonjës, si më poshtë:

- *****, akt nr. 3997/2 prot, datë 25.05.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Ceretifikimit dhe Mbikëqyrjes së Sigurisë*”.
 - Indrit Purde, akt nr. 2804/7 prot., datë 14.05.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist IT*”.
 - *****, akt nr. 2804/8 prot., datë 14.05.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë*”.
 - *****, akt nr. 2804/5 prot., datë 14.05.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Transportin Ajror*”.
 - *****, akt nr. 2804/4 prot., datë 14.05.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë*”.
 - *****, akt nr. 2804/3 prot., datë 14.05.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerëve*”.
 - *****, akt nr. 2804/2 prot., datë 14.05.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerëve*”.
 - *****, akt nr. 2804/3 prot., datë 14.05.2018, si nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve të Lundrimit Ajror*”.
- ✓ *Hartimi i përshkrimeve dhe i vlerësimeve të punës për të gjithë pozicionet e shërbimit civil sipas standardeve të përcaktuara.*

Në lidhje me këtë aspekt, nga këqyrja e formularëve të përshkrimit të punës të administruar nga grupi i verifikimit, konstatoj se njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me eprorët direkt, si aktorë të përcaktuar nga ligji për realizimin e këtij procesi, ka hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

- ✓ *Administrimi i aspekteve të ndryshme të shërbimit civil nga ana e institucionit, për rregullimin e ligjshmërisë.*

Në lidhje me këtë aspekt, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ka bashkëvepruar me njësinë e burimeve njerëzore të ministrisë nga e cila varet institucioni, dhe Departamentin e Administratës Publike, si aktorë të përcaktuar nga ligji për zbatimin e reformave strukturore dhe funksionale.

Gjithashtu, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ka bashkërenduar punët me njësitë e tjera pjesë të strukturës së institucionit, për të siguruar zbatimin e parimeve të sanksionuara në ligjin e shërbimit civil dhe respektimin e procedurave ligjore për çdo institut të tij, duke përmbushur në këtë drejtim të gjitha orientimet e lëna nga Komisioneri në vendimin paralajmërues.

Duke vlerësuar punën e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe njësisë përgjegjëse (DAP), si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 38, datë 27.04.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe njësisë përgjegjëse (DAP), duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.38, datë 27.04.2018.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha